FLETËUDHËZUES I PAKETIMIT:
Informacion për përdoruesin

Virzin

Krem – 5 %
(Aciklovir)

Lexojeni me kujdes këtë fletëudhëzues përpara se të filloni përdorimin e barit.
- Ruajeni këtë fletëudhëzues. Mund të keni nevojë ta lexoni përsëri.
- Në qoftë se keni pyetje të mëtejshme, pyesni mjekun ose farmacistin tuaj.
- Ky bar është përshkruar për ju. Mos e jepni tek persona të tjerë. Mund t'i dëmtojë ata edhe pse mund të kenë të njëjtat simptoma si ju.
- Në qoftë se ndonjë prej efekteve anësore keqësohet ose në qoftë se vëreni ndonjë efekt tjetër anësor që nuk përmendet në këtë fletëudhëzues, ju lutemi të njoftoni mjekun ose farmacistin tuaj.

Në këtë fletëudhëzues:

1. Çfarë është Virzin dhe përse përdoret
2. Përpara se të përdorni Virzin
3. Si ta përdorni Virzin
4. Efekte anësore të mundshme
5. Si ta ruani Virzin
6. Informacion i mëtejshëm

1. ÇFARË ËSHTË VIRZIN DHE PËRSE PËRDORET

Virzin ka si lëndë vepruese aciklovir, i cili është një frenues i replikimit të ADN virale duke interferuar me ADN-polimerazën. Dozat e Virzin që administrohen lokalisht kanë një përthithje minimale. Acikloviri jashtëqitet nga veshkat me filtrim glomerular dhe sekretim tubular.
Virzin krem përdoret për trajtimin fillestar dhe rekurrent të infeksioneve Herpes simplex të lëkurës, labial dhe gjenital.

2. PËRPARA SE TË PËRDORNI VIRZIN

Mos përdorni Virzin:
- në qoftë se jeni alergjik nga acikloviri ose përbërësit e tjerë të kremit dhe në qoftë se pacienti ka ndonjë histori tjetër alergjie nga antiviralë të tjerë;
- në qoftë se pacienti është fëmijë nën 2 vjeç.

Tregoni kujdes të veçantë me Virzin
Virzin krem është vetëm për përdorim dermatologjik dhe nuk duhet të përdoret në sy, në membranat mukoze të gojës ose vaginës, sepse mund të shkaktojë irritim lokal.

Marrja e barnave të tjera:
Ju lutemi të kontaktoni me mjekun ose farmacistin tuaj në qoftë se jeni duke marrë / përdorur ose keni marrë / përdorur kohët e fundit barna të tjera, përfshirë ato të marra pa recetë.
Mos harroni të informoni mjekun tuaj për trajtimin me Virzin në qoftë se ju jepet ndonjë bar tjetër gjatë trajtimit.
Megjithatë, përvoja klinike nuk ka identifikuar ndonjë ndërveprim të aciklovirit krem si rezultat i administrimit lokal ose sistemik të barnave të tjerë njëkohësisht me të.

Shtatzënia
Kërkoni këshillën e farmacistit ose të mjekut përpara se të përdorni këtë bar.
Virzin, meqë ka si lëndë vepruese aciklovir, nuk duhet të përdoret gjatë shtatzënisë, përveç rasteve kur të mirat që sjell bari justifikojnë rrezikun mbi fetusin.

Ushqimi me gji
Nuk dihet akoma nëse pas aplikimit lokal të kremit të aciklovirit, lënda aktive kalon apo jo në qumështin e gjirit. Duhet të tregohet kujdes kur ky bar përdoret nga nënat që ushqejnë me gji foshnjet.

Drejtimi i automjetit dhe përdorimi i makinerive
Efekti i këtij bari mbi aftësinë për të drejtuar automjetin dhe përdorur makineri është i padëmshëm.

Informacione të rëndësishme për disa nga përbërësit e Virzin
Ky bar përmban:
- alkol cetilik, i cili mund të shkaktojë reaksione lokale në lëkurë (p.sh. dermatit kontakti)
- propilen glikol, i cili mund të shkaktojë irritim të lëkurës.

3. SI TA PËRDORNI VIRZIN

Gjithmonë përdoreni Virzin sipas këshillës së mjekut. Në qoftë se nuk jeni i sigurt kontaktoni me mjekun ose farmacistin. Në qoftë se ndjeni që efektet e aciklovirit janë shumë të forta ose shumë të dobëta, flisni me mjekun ose farmacistin tuaj.
Për trajtimin e infeksioneve virale të formave të përshkruara më lart rekomandohet aplikimi i një sasie të mjaftueshme kremi sa për të mbuluar plotësisht lezionet, çdo 4 orë, 5 herë në ditë, për 5 ditë. Në qoftë se pas 5 ditësh nuk arrihet shërimi i plotë, atëherë mjekimi mund të vazhdojë edhe për 5 ditë të tjera. Doza që aplikohet varet nga sipërfaqja totale e lezioneve.
Doza mund të ketë nevojë të rritet ose të reduktohet. Mjeku juaj duhet t'ju këshillojë si të veproni.
Gishti ose doreza prej gome që përdoret për aplikimin e kremit nuk duhet të prekë pjesë të tjera të trupit ose persona të tjerë, sepse mund t'i transmetohet infeksioni në vendet ku preken.
Terapia duhet të fillojë sa më shpejt të jetë e mundur. Është veçanërisht e rëndësishme që mjekimi i episodeve rekurrente të fillohet gjatë periudhës prodromale ose sapo të shfaqen simptomat.

Në qoftë se keni përdorur më shumë Virzin
Në qoftë se keni përdorur më shumë Virzin se sasia që duhet të përdornit, ose në qoftë se fëmijët e kanë marrë gabimisht këtë bar, ju lutemi të kontaktoni mjekun tuaj, spitalin ose të telefononi urgjencën për të marrë një mendim për rrezikun dhe këshillë për veprimet që duhet të ndërmerren.
Raste mbidozimi nuk njihen sepse përthithja nëpërmjet lëkurës është minimale.

Në qoftë se keni harruar të përdorni Virzin
Në qoftë se harroni një dozë (ose më shumë doza), përdorni dozën në vazhdim kur të jetë koha për përdorimin e zakonshëm të saj.
Mos përdorni një dozë të dyfishtë (ose më të lartë) për të plotësuar dozën (dozat) e harruar(a).
Në qoftë se keni pyetje të mëtejshme mbi përdorimin e këtij produkti, pyesni mjekun ose farmacistin tuaj.

4. EFEKTE ANËSORE TË MUNDSHME

Si të gjithë barnat e tjera, Virzin mund të shkaktojë efekte anësore, megjithëse jo çdokush i manifeston.
Pjesa më e madhe e efekteve anësore janë të lidhura me dozën dhe zhduken kur doza reduktohet ose trajtimi ndërpritet. Disa efekte anësore mund të ndodhin në fillim të trajtimit dhe zhduken në mënyrë spontane me vazhdimin e mjekimit.
Efektet e padëshiruara që mund të shfaqen janë:
- tharje dhe deskuamim i lëkurës;
- pickim ose djegie kalimtare;
- prurit;
- rash.

Në qoftë se ndonjë prej efekteve anësore përkeqësohet, ose në qoftë së vëreni efekte anësore që nuk përmenden në këtë fletëudhëzu-es, ju lutemi të lajmëroni mjekun ose farmacistin tuaj.

5. SI TA RUANI VIRZIN

Mbajeni larg fëmijëve.
Mos e përdorni kremin Virzin pas datës së skadimit e cila është e shënuar në paketim.
Mos e ruani mbi 25°C.
Ruajeni në paketimin origjinal për ta mbrojtur nga drita.

6. INFORMACION I MËTEJSHËM

Çfarë përmban Virzin
Lënda vepruese është aciklovir.
1 g krem përmban 50 mg aciklovir.
Përbërësit e tjerë janë: Glicerolmonostearat dhe polietilenglikol - 30 - stearat, dimetikon 350 fluid, alkool cetilik, parafinë e bardhë, vaj parafine, propilenglikol, ujë i pastruar.

Përmbajtja e paketimit
Kuti kartoni me 1 tub 5 g ose 15 g.

Mbajtësi i autorizimit të tregtimit dhe prodhuesi:

PROFARMA Sh.a.
Rruga "Myslym Keta"
Tel.Fax: 00355 4 23 62 800
Tiranë - SHQIPËRI

Ky fletëudhëzues u rishikua për herë të fundit në Prill 2015.

SPECIFICATION

CROPING AREA 12 x 19 cm

PAY ATENTION, all the layers are visible.
If you have to print this document please check or uncheck the specific layers.